



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:264617
Datë: 24.01.2025
Numri i dokumentit: 06755707

ARJ.nr.160/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi kryetare, Ragip Namani dhe Beshir Islami anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “B. G.” SHPK me seli në L., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të paditurës nr.01.3.2.2/668 të datës 10.12.2018, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1054/22, të datës 18.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22 janar 2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi “B. G.” SHPK me seli në L., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1054/22, të datës 18.12.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1054/22, të datës 18.12.2023, është vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit “B. G.” Shpk me seli në L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.181/19, të datës 14.06.2021, VËRTETOHET.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1054/22, të datës 18.12.2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.1054/22, të datës

18.12.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.181/19, të datës 14.06.2021, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr.01.3.2.2/668 të datës 10.12.2018, e paditura Dogana e Kosovës, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve me nr. R-9..., R-9..., R-9.. 9..., të datës 04.10.2018, R-9.. të datës 05.10.2018, R-9...,R-9..., R-9..., R-9.., R-9.. të datës 06.10.2018, R-9..., R-9..., R-9.. të datës 09.10.2018, R-9..., R-9..., R-9..., R-9.., R-9.. të datës 11.10.2018, R-9..., R-9..., R-9.. të datës 13.10.2018, R-9..., R-9.. të datës 16.10.2018, R-1..., R-1..., R-1., R-1..., R-1..., R-1.. të datës 22.10.2018, R-1..., R-1..., R-1.. të datës 24.10.2018, R-1.. të datës 25.10.2018, R-1..., R-1..., R-1..., R-1..., R-1..., R-1.. të datës 26.10.2018, R-1..., R-1..., R-1..., R-1.. të datës 27.10.2018 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtina 3, me të cilat vendime paditësi i është kontestuar dhe rivlerësuar vlera e deklaruar e mallit.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.181/19, të datës 14.06.2021, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadi e paditësit "B. G." SHPK me seli në L., me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi me nr.01.3.2.2/668, i datës 10.12.2018, i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia kthej mjetet monetare në emër të detyrimeve doganore për mallin e zhdoganuar me Deklaratat Unike Doganore me nr.R-9..., R-9..., R-9..., 9..., të datës 04.10.2018, R-9.. të datës 05.10.2018, R-9..., R-9..., R-9..., R-9..., R-9.. R-9.. të datës 06.10.2018, R-9..., R-9..., R-9.. të datës 09.10.2018, R-9..., R-9..., R-9..., R-9..., R-9.. të datës 11.10.2018, R-9..., R-9..., R-9.. të datës 13.10.2018, R-9..., R-9.. të datës 16.10.2018, R-1..., R-1..., R-1..., R-1..., R-1..., të datës 22.10.2018, R-1..., R-1..., R-1.. të datës 24.10.2018, R-1.. të datës 25.10.2018, R-1..., R-1..., R-1..., R-1..., R-1..., R-1.. të datës 26.10.2018, R-1..., R-1..., R-1..., R-1.. të datës 27.10.2018, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 3, në shumë prej 5,023.66€ (pesë mijë e zero njëzet e tri euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent). II. Mbetet në fuqi aktvendimi me nr.01.3.2.2/668, i datës 10.12.2018, i Doganës së Kosovës. III. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Nga kjo gjendje e fakteve, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se, paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është

vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues, përkatësisht i njëjti nuk ka arritur që me prova bindëse të dëshmojë vlerën e deklaruar të mallit lëndor siç kërkohet me nenin 31 par.1 të KDAK-së, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative-juridike. Gjykata konstaton se nuk janë të bazuara pretendimet e paditësit për shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, për arsye se, në rastin konkret vërtetohet se Dogana e Kosovës ka zhvilluar të gjitha procedurat e duhura në harmoni me ligjet pozitive, dhe se nuk ka pasur asnjë shkelje të procedurës administrative-doganore, meqë rasti është trajtuar në mënyrë të rregullt dhe të drejtë në të gjitha fazat e vendimmarrjes, konform autorizimeve dhe dispozitave ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109.

Pretendimi i paditësit për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk është i bazuar, për faktin se në rastin konkret nga provat shkresore të administruara në këtë procedurë gjyqësore nuk është dëshmuar se vlera e deklaruar e mallit është çmimi realisht i paguar nga paditësi. Në këtë drejtim gjykata konstaton se paditësi për të provuar vlerën e deklaruar të mallit lëndor DUD-ve kontestues i ka bashkangjitur faturat e blerjes së mallit me nr.IRA1..., IRA1..., IRA1..., IRA1..., të gjitha këto të datës 26.10.2018, faturat me nr.IRA1..., IRA1..., IRA1..., IRA1..., IRA1..., të datës 24.10.2018, faturat me nr.IRA1..., IRA1..., të datës 25.10.2018, faturat me nr.IRA-1..., nr.IRA-1..., nr.IRA-1..., të datës 23.10.2018, faturën me nr.IRA-1..., të datës 19.10.2018, faturën me nr. IRA-1..., IRA-1..., IRA-1..., IRA-1..., IRA-1..., të datës 20.10.2018, faturat me nr.1..., 1..., të datës 15.10.2018, faturat me nr.1..., 1..., 1..., të datës 12.10.2018, faturat me nr.2..., 2..., 2..., 2..., 2..., të datës 10.10.2018, faturat me nr.245701800068, 245701800067, 245701800069, të datës 08.10.2018, faturat me nr.2..., 2...,2..., 2..., 2..., 2..., të datës 05.10.2018, faturën me nr.2..., të datës 04.10.2018, faturat me nr.2..., 2..., 2..., 2..., 2... të datës 03.10.2018, pastaj ka bashkangjitur kontratat e shitblerjes të lidhur me eksportuesit e mallit të datës 03.10.2018, 17.10.2018, deklaratat eksportuese nga shteti eksportues, certifikatat e origjinës së mallit EUR.1, si dhe ka bashkangjitur edhe transaksionet bankare-S.. C.. të datave 19.10.2018, 25.10.2018, 19.10.2019, 22.10.2018, 04.10.2018, 08.10.2018, 10.10.2018, pagesa këto të cilat janë bërë në emër të pro faturave me nr.IPR1..., të datës 17.10.2018, dhe asaj me nr.1.. të datës 03.10.2018, pro fatura këto të cilat paditësi nuk i ka bashkangjitur fare shkresave të lëndës.

Në vazhdim ka theksuar se: Nisur nga kjo situatë faktike gjykata nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e pagesave bankare me vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, sepse siç rezulton nga pagesat bankare të paraqitura si provë nga paditësi, të njëjtat janë bërë në emër të pro faturave dhe jo faturave të mallit lëndor, për çka gjykata e ka pasur të pamundur të bëjë harmonizimin pagesave me vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi në DUD-at e kontestuar dhe në faturat e mallit lëndor. Gjykata nuk e konteston faktin se transaksionet bankare të datave 19.10.2018, 25.10.2018, 19.10.2019, 22.10.2018, 04.10.2018, 08.10.2018, 10.10.2018, si përfitues të mjeteve financiare nga paditësit janë eksportuesit e mallit nga Serbia "P."L.T.C D.. dhe "S. F. S." AD, mirëpo gjykata nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e këtyre pagesave në kuptim të përshkrimit të faturave të mallit.

Gjykata vlerëson se nuk janë të bazuara pretendimet e paditësit se mallin lëndor e kanë përcjell të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat kërkohen për vendosje të mallit në qarkullim të lirë, duke përmendur faturat përcjellëse të mallit dhe transaksionet bankare, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm dhe jo i harmonizuar në kuptim të përshkrimit të pagesave për mallin e importuar, për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqitur vlerën reale të mallit lëndor. Ngase, thekson se për tu pranuar vlera e paguar e transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 par. 1 të KDAK-së, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën i'a ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor, përmes transaksioneve të cilat janë të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit të mallit-faturave të blerjes apo që i njëjti krahas faturave përcjellëse të mallit është dashur ti paraqes si provë edhe pro faturat e mallit të shënuara në transaksionet bankare, për ti krahasuar ato më pastaj nëse të njëjtat harmonizohet me faturat e mallit dhe pagesat bankare.

Në referim të nenit 33 par.1 dhe 34 par. 1 dhe 2 të KDAK-së, gjykata e shkallës së parë vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur e ka vlerësuar mallin lëndor të paditësit, duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit, në mbështetje të nenit 35 të këtij kodi, në bazë të dhënave të disponueshme të marra për çmimin e sheqerit nga b. "R.", për datën e faturimit të mallit, nga ku është konstatuar se është deklaruar vlerë më e ulët se sa vlera reale e mallit. Vlerësimi i mallit lëndor duke u bazuar në të dhënat e disponueshme për mallrat e ngjashëm, gjykata e konsideron vlerësim të drejtë dhe të bazuar në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Ndërsa në kuptim të nenit 81.F par.1 të Ligjit nr. 04-L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për ATK, tatimpaguesi do të bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj. Prandaj, në bazë të gjendjes faktike, ballafaqimit dhe ekzaminimit të gjitha provave në dosje të dokumentacionit shkresore, gjykata konstaton se vendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/668 i datës 10.12.2018, është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-099. Andaj, në kuptim të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për ATK, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, neni 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera thekson se: Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, përkatësisht se gjykata nuk e ka marrë parasysh nenin 70 të UA 11/2009, këto pretendime kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj pasi

konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmojë provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të KDAK-së. Pasi që gjykata ka theksuar se për tu pranuar vlera e paguar e transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 paragrafi 1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, në këtë rast paditësi është dashur ti paraqes si provë edhe pro faturat e mallit të shënuara në transaksionet bankare, për të bërë krahasimin nëse të njëjtat harmonizohen me faturat e mallit dhe pagesat bankare.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kolegji ka vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar drejtë, në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109 dhe të UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Malli lëndor, me të drejtë është rivlerësuar në bazë të metodës së 6 të vlerësimit në pajtim me nenin 35 i KDAK-së, përkatësisht në bazë të dhënave të disponueshme, përkatësisht nga Sektori i Vlerës për çmimin e sheqerit nga Reuters. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, dhe në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës, me nr.01.3.2.2/668, të datës 10.12.2018, me të cilin refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë "B. G." shpk, me seli në P., për rishqyrtimin e aktvendimit të lartcekur, të lëshuar nga Zyra e Brendshme Doganore Prishtina 3, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se: Gjykata e Komerciale – Dhomat e Shkallës s Dytë nuk e ftoi parashtruesin e kërkesës dhe as nuk mbajti një seancë publike në pajtim me nenin 81.G të Ligjit nr. 04-L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222., Kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i

refuzoi në tërësi si të pabazuara, për faktin se paditësi para gjykatës së shkallës së parë ka pasur mundësi në seancë publike si dhe me prova të tjera të dëshmojë se vendimi i kontestuar nuk është i drejtë dhe me qenë se këtë të drejtë paditësi e ka konsumuar para gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se nuk kemi asnjë provë, fakt apo rrethanë të re e cila do të ishte e nevojshme të vlerësohej në një seancë tjetër publike dhe se edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate e njëjta ka vepruar drejtë për shkak të ekonomizimit të procedurës dhe zvarritjes së çështjes e që mos mbajtja e një seance publike ka ndikuar pozitivisht edhe tek paditësi për shkak të mos zvarritjes së çështjes pa asnjë arsye të pranueshme e cila do të ndikonte në një vendim marrje ndryshe, andaj edhe kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se paditësi as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatës, nuk ka arritur që të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me vendimin kontestues, dhe nga dëshmitë e parashtruara nuk mund të vërtetohet vlera reale e mallit të zhdoganuar.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkelje të dispozitave të procedurës apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, vlerësoj se këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.160/2024, më datë 22 janar 2025

B. Profesionale
Zanë Buçinca

Kryetare e Kolegjit
Delushe Halimi